



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.376/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj-Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Koalicionit, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-NISMA, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 06.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohen si të pa bazuara ankesat e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.376/2025, Anr.377/2025, Anr.378/2025, të datës;04.02.2025, të ushtruara kundër koalicionit, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-NISMA me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë;04.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuar me numër Anr.376/2025, Anr.377/2025, Anr.378/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-NISMA, me seli në Prishtinë. Në ankesën Anr.376/2025, Pretendohet se me datë;04 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, gjatë monitorimit të tubimeve politike ka vërejtur gjuhë denigruese dhe fyese nga kandidati për deputet z. Besnik Krasniqi, në tubimin e mbajtur në qytetin e Prizrenit, me datë;03.02.2025 të koalicionit AAK-Nisma, qeverinë e kaluar dhe mandatin qeverisës të drejtuar nga subjekti jonë LVV, e quan qeveri që për 4 vite ka mashtruar qytetarët, ka manipuluar, ka "kapur" shtetin dhe ka PËRNDJEKUR qytetarët. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur CD nga fjalimi.

Në ankesën Anr.377/2025, pretendohet se më 04 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, gjatë monitorimit të tubimeve politike ka vërejtur gjuhë denigruese dhe fyese nga kandidati për deputet z. Fatmir Limaj, në tubimin e mbajtur në qytetin e Prizrenit, më datë;03.02.2025 të koalicionit AAK-NISMA, qeverinë e kaluar dhe mandatin qeverisës të drejtuar nga subjekti jonë LVV, e quan përçarëse, mashtruese dhe po ashtu shpifëse dhe gënjeshtare. Parashtrues i ankesës si provë ka bashkangjitur CD nga fjalimi

Në ankesën Anr.378/2025 pretendohet se më 04 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, gjatë monitorimit të tubimeve politike ka vërejtur gjuhë denigruese dhe fyese nga kandidati për deputet z. Ramush Haradinaj, në tubimin e mbajtur në qytetin e Prizrenit, me datë 03.02.2025 të koalicionit AAK-NISMA, akuzon qeverinë për terrorizimin e bizneseve. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur CD nga fjalimi

Në përgjigjen në ankesa të koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK-NISMA theksohet si në vijim: Në përgjigjen për ankesën Anr.376/2025 të datës 35.01.2025, Koalicioni AAK-NISMA, vlerëson se ankesa është e pa bazuar dhe se z. Krasniqi si individ dhe përfaqësues politik ka të drejtë të shprehë mendimin e vet kritik mbi punët e qeverisë dhe se gjuha e përdorur und të jetë kritike por kjo nuk e bën të dëmshme për shoqërinë. I njëjti me fjalën “përndjekur” ka nënkuptuar migrimin e qytetarëve për një jetë më të mirë në vendet e zhvilluara kryesisht evropiane.

Në përgjigjen për ankesën Anr.377/2025, theksohet se z. Limaj ka shprehur vetëm një opinion kritik ndaj një grupi politik që është plotësisht e lejueshme në një shoqëri demokratike.

Në përgjigjen për ankesën Anr.378/2025, theksohet se deklarimi i z. Haradinaj është dekontekstualizuar dhe se dhe se ofrimi i një alternative ndryshe për Lëvizjen Vetëvendosje qenka gjuhë fyese dhe denigruese.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.376/2025, A.nr.377/2025, Anr.378/2025 të paraqitura me datë 04.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.376/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër subjektit të njëjtë politik Lista Serbe, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, vëren se ankesat janë të pa bazuara, për faktin se pas shikimit të video incizimit të ofruara si prova materiale nga ankuesi, shihet kandidati për deputet nga radhët e koalicionit AAK-NISMA z. Besnik Krasniqi, në tubimin e mbajtur në qytetin e Prizrenit, më datë;03.02.2025 të koalicionit AAK-NISMA, qeverinë e kaluar dhe mandatin qeverisës të drejtuar nga subjekti jonë LVV, e quan *qeveri që për 4 vite ka mashtruar qytetarët, ka manipuluar, ka "kapur" shtetin dhe ka PËRNDJEKUR qytetarët*. Po ashtu kandidati për deputet z. Fatmir Limaj, në tubimin e mbajtur në qytetin e Prizrenit, me datë;03.02.2025 të koalicionit AAK-NISMA, qeverinë e kaluar dhe mandatin qeverisës të drejtuar nga subjekti jonë LVV, e quan *përçarëse, mashtruese dhe po ashtu shpifëse dhe gënjeshtare*. Gjithashtu kandidati për deputet z. Ramush Haradinaj, në tubimin e mbajtur në qytetin e Prizrenit, me datë;03.02.2025, të koalicionit AAK-Nisma, akuzon qeverinë për

terrorizimin e bizneseve.” Dhe duke i vlerësuar këto deklaratime të kandidatëve, Paneli vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe të urrejtjes në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Fjalimet e tilla të përdorura nga kandidatët e koalicionit AAK-NISMA hyn në diskursin e fushatës zgjedhore, dhe nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon një person tjetër për të kryer një akt dhune kundër personave të tjerë ose pasurisë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), e LZP-së, në të cilin nen përcaktohet se “*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.376/2025, datë;06.02.2025

Kryesues i Panelit
Hajriz Hoti



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.